



01 Nr.01/26
Rahovec: 04.02.2026

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/94 Nr. i faq/Br.str/No.pg 85
Data/Datum/Date 04 / 02 / 2026

Në bazë të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës 03/L-040, nenit 4 pika 2 të Ligjit për Hoçën e Madhe, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësit dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Vendimit 01 Nr. 85 / 26 për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, kuvendi i Komunës së Rahovecit shpall këtë:

Ftesë Publike **Për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe**

Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe përbëhet prej 5 anëtarëve, gjegjësisht 2 qytetar të Komunës së Rahovecit – Shqiptar, 2 banorë të fshatit Hoçë e Madhe dhe një nga Kisha Ortodokse Serbe, i cili duhet të jetë banor i fshatit Hoçë e Madhe.

Përgjegjësitë e Këshillit, ndër të tjera, kanë të bëjnë me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin trashëgimisë fetare dhe kulturore si dhe planifikimi hapësinor dhe rural të fshatit Hoçë e Madhe.

Ftohen të interesuarit që të konkurrojnë për anëtarë të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Preferohet që anëtarët të kenë përvojë në lëmit vijuese:

- Ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të fshatit Hoçë e Madhe, si dhe të komunës së Rahovecit në tërësi,
- Gjithashtu, preferohet që anëtarët e këshillit të kenë kualifikime relevante – superiore siç janë: arkitektë, historian, arkeologë, gjeograf ose pjesëtar të OJQ-ve të ndryshme të cilat merren me njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Aplikacionet, që përbëhen nga kërkesa, CV –në dhe dëshmitë për përvojën tuaj në lëmit e theksuara më lartë, duhet t'i dorëzoni në zyrën e pranimit të KK-së, duke cekur për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Ftesa mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit të saj në veb-faqen zyrtare të komunës si dhe në mjetet e informimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit, respektivisht pas datës 18.02 2026, nuk do të merren në shqyrtim.



Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Iska